

	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v.2.0	Faqe 1 nga 2

Kodi: 070

NDËRMJETËSIMI NË MES BASHKËMOSHATARËVE

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Programi “Ndërmjetësimi në mes bashkëmoshatarëve” është zhvilluar si rezultat i punës disavjeçare në kuadër të projekteve për parandalimin e dhunës në shkolla, më konkretisht, në vitin 2013, kur është hartuar dhe aprovuar “Rregullorja QRK 21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar”. Hartimi i kësaj rregulloreje u inicua në kuadër të projektit “Parandalimi i dhunës në shkolla”, të zbatuar nga KEC dhe të përkrahur nga UNICEF. Në nenin 9, pikën 1.8, shkollat inkurajohen të themelojnë dhe të funksionalizojnë ekipet e ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve. Që nga viti 2015 është punuar në finalizimin e programit të trajnimit, duke u bazuar në përvojat dhe praktikën më të mira nga shkollat e Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Qëllimet e programit:

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë çfarë është konflikti, cilat janë llojet e konfliktit, natyra e konflikteve në shkolla;
- Të kuptojnë rëndësinë e komunikimit në zgjidhjen e konflikteve;
- Të përvetësojnë teknika dhe metoda për ndërmjetësim mes bashkëmoshatarëve;
- Të jenë të gatshëm për të zhvilluar seanca ndërmjetësimi;
- Të jenë të gatshëm për të shpërndarë dijet dhe informacionet edhe tek palët e treta.

Përmbajtja:

Ndërmjetësimi është një proces i strukturuar në të cilën një palë e tretë neutrale u ndihmon njerëzve ose grupeve të përfshira në një mosmarrëveshje për të komunikuar dhe për të zgjidhur konfliktin. Qëllimi i ndërmjetësimit në mes bashkëmoshatarëve është zgjidhja e konflikteve në mënyrë jo të dhunshme dhe të qëndrueshme. Ndërmjetësimi është një proces vullnetar, i cili zhvillohet me hapa dhe praktika të përcaktuara që udhëheqin një palë të tretë të paanshme, ndërmjetësuesin, në sjelljen e tij ose të saj. Në kontekstin shkollor, nxënësit dhe mësuesit veprojnë si ndërmjetësues për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet nxënësve, por edhe konfliktet ndërmjet nxënësve dhe mësuesve, drejtorëve apo

 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	SYLLABUSI I PROGRAMIT TË TRAJNIMIT		F-042
	Prishtinë	v.2.0	Faqe 2 nga 2

prindërve. Megjithatë, përtej të qenit vetëm një proces teknik, ndërmjetësimi nxit një frymë të veçantë, të mbështetur në vlerat e tij themelore. Si rezultat, efekti i ndërmjetësimit shpesh shkon përtej zgjidhjes së konflikteve. Në kontekstin shkollor, raportohet vazhdimisht se zbatimi i ndërmjetësimit ndikon pozitivisht në klimën e shkollës, duke nxitur një frymë më bashkëpunuese dhe më optimiste, duke u mundësuar nxënësve, mësime ndërmjetësuese dhe prindërve të ndihen më të përfshirë dhe zhvillojnë një ndjenjë më të fortë përkatesie dhe përgjegjësie ndaj shkollës në tërësi.

Grupi i synuar

Ky program u dedikohet nxënësve, mësime ndërmjetësuese, psikologëve shkollorë, pedagogëve, drejtorëve të shkollave dhe personave të tjerë që merren me zgjidhje të konflikteve (përfaqësues të QPS-së, PK-së, OshC-ve).

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi organizohet përmes sesioneve trajnuese dhe zgjat tri ditë: dy ditë trajnim dhe një ditë praktikë. Gjatë dy ditëve të para ofrohet e gjithë përmbajtja e trajnimit, ndërsa dita e tretë zhvillohet në shkollë, ku pjesëmarrësit përmbushin disa detyra specifike, më konkretisht, zbatojnë në praktikë teknikat, metodat dhe shkathtësitë e fituara gjatë trajnimit. Numri i pjesëmarrësve në trajnim është 25-30.

Vlerësimi/Certifikimi

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të certifikohen për gjithsej 24 orë trajnim. Të gjithë pjesëmarrësit do të simulojnë seanca ndërmjetësimi, ndërsa trajnerët i vlerësojnë ata në bazë të performancës gjatë këtyre seancave.

Certifikohen vetëm pjesëmarrësit që arrijnë së paku 50% të pikëve të vlerësimit dhe që kanë vijueshmëri të plotë në sesionet trajnuese.

Materialet e trajnimit

1. Doracak për ekipet ndërmjetësuese mes bashkëmoshatarëve, KEC/UNICEF, Maj 2016.
2. Hyrje në ndërmjetësimin mes bashkëmoshatarëve, forumZFD, OSCE, Shtator 2014.
3. Udhëzues për trajnerë, KEC/forumZFD, Maj 2017.
4. Materiale të tjera (fletëshpërndarëse, prezantime, video –materiale).